

Broshura me planet e Serbisë për Kosovën

Tetor 2006

Planet aktuale serbe për rikolonizimin e Kosovës

Serbia synon që në muajt dhe vitet e ardhshme, në kuadër të planeve për copëtimin dhe gllabërimin e Kosovës, ta realizojë kthimin e organizuar dhe masiv të serbëve në Kosovë. Ky kthim mbështetet në standardin e katërt dhe quhet 'kthim i qëndrueshëm'. Serbia ka arritur që UNMIK-ut, IPVQ-ve dhe shumë faktorëve ndërkombëtar t'ua imponojë tezën se serbët gjoja nuk janë të sigurtë në Kosovë dhe se ata nuk mund të kthehen në Kosovë ngase shqiptarët do t'i dëbonin. Së pari, siç ka pohuar edhe përfaqësuesi i UNHCR-së, Ron Redmond, shumica dërrmuese e serbëve të Kosovës shkuan nga Kosova së bashku me forcat policore dhe ushtarake të Serbisë në qershor të vitit 1999. Së dyti, Serbia nuk do që serbët të kthehen atje ku ata i kanë pronat e tyre, meqë gjithandej do të jenë siç ishin - pakicë e thjeshtë. Ministri për Kthim dhe Komunitete në qeverinë e Kosovës, Slavisha Petković, për radion B92, më 5 mars 2005, ka deklaruar: "Për një muaj, 85 familje janë kthyer në Kosovë. Kjo është më shumë sesa ajo që ka arritur të bëjë Nebojsa Çović për pesë vjet." Së treti, Beogradi pohon se në Kosovë jetojnë 132.012 serbë dhe joshqiptarë, ndërsa janë 228.409 refugjatë të ikur nga Kosova pas luftës. Beogradi qëllimisht është i dobët në matematikë. Në bazë të këtyre të dhënave, del se ka më shumë refugjatë serbë nga Kosova sesa serbë që kishin jetuar ndonjëherë në Kosovë! Sipas Institutit Statistikor të Republikës së Serbisë ishin rreth 190.000 serbë të cilët jetonin në Kosovë në vitin 1991. Numri i serbëve në Kosovë nuk ka ndryshuar aq përgjatë viteve të 90-ta. Këtë e vërteton edhe Iniciativa Europiane për Stabilitet (ESI), e cila në njërin prej raporteve të veta thekson se në Kosovë jetojnë 130.000 serbë dhe janë 60.000 serbë refugjatë nga Kosova. Serbët e mbetur në Kosovë nuk do të qëndronin këtu sikur mos ta kishin jetesën më të mirë sesa në Serbi. Serbia i përçmon serbët e Kosovës dhe i lë që të jetojnë nëpër baraka në mjerim ekonomik e social, në mënyrë që atëherë kur të paraqitet një moment i volitshëm politik për t'i kthyer masivisht në Kosovë, serbët të mos kundërshtojnë ardhjen dhe të jetuarit këtu. Kur kësaj i shtohen edhe 140.000 serbë në Serbi të cilët janë refugjatë nga Kroacia dhe Bosnja, e të cilët Serbia pa problem mund t'ua falsifikojë dokumentet dhe t'i paraqesë ata si ish banorë të Kosovës, bëhet e qartë se Serbia nuk

VETËVENDOSJE !

ka problem me gjetjen e një numri të madh të serbëve që do t'i sillte në Kosovë. Një anketë e zhvilluar në nëntor të vitit 2004, në kuadër të hulumtimit të përbashkët të USAID-it, UNDP-së dhe RIINVEST-it, në shtator-dhjetor 2004, tregoi se 30% të shqiptarëve të Kosovës dhe vetëm 12.3% të serbëve të Kosovës mendojnë të emigrojnë nga Kosova. Pra, janë shqiptarët ata që duan ta lëshojnë Kosovën dhe jo serbët, ngase pikërisht shqiptarët janë në pozitë më të vështirë politike dhe sociale. Sa për ilustrim, ta marrim shembullin e Mitrovicës. Sipas një tjetër raporti të ESI-t, në veri të Mitrovicës dhe Zveçan jetohet me mesatarisht 95 euro në muaj, 60% të të cilave sigurohen nga Beogradi dhe 23% nga Prishtina. Ndërkaq, në jug të Mitrovicës njerëzit jetojnë me 37 euro në muaj, nga të cilat 37% sigurohen nga Qeveria e Kosovës dhe 40% nga sektori privat.

Serbia nuk do që t'i kthejë serbët atje ku ata do të ishin pakicë, sepse asisoj nuk do të mund të ushtronte ndikimin politik të tillë çfarë do që ta ketë. Serbia aspiron që serbët t'i kthejë atje ku ata janë shumicë për ta përforcuar edhe më shumë këtë shumicë, atje ku ata do të bëheshin shumicë nëpërmjet kthimit, ose atje ku do të siguronin vazhdimësi territoriale të enklavave serbe. Shumica dërrmuese e serbëve të Kosovës në të kaluarën jetonin nëpër qytete, d.m.th. ishin pakicë aty ku banonin. Dhjetëra mijëra serbë të kthyer në Prishtinë nuk do ta kishin as për së afërmi peshën e disa qindra serbëve të kthyer në pjesë të caktuara që do të mundësonin lidhjen e trevave ekzistuese të kontrolluara nga Qeveria e Serbisë drejt krijimit të entitetit autonom territorial të serbëve të Kosovës përbrenda Kosovës. Andaj, përdoret formulimi 'kthim i qëndrueshëm' dhe jo vetëm 'kthim'. Serbisë iu plotësua dëshira që të ketë të drejtë që serbët t'i kthejë edhe atje ku ata s'kanë jetuar më parë; pra, jo te prona e tyre dhe në pronën e tyre, por në vendbanime të reja që do të forconin e zgjeronin enklavat aktuale drejt bashkimit të tyre. 'Kthimi i qëndrueshëm' nuk është gjë tjetër veçse rikolonizim. Më 18 prill 2006, në Beograd, Kilian Kleinschmidt, drejtor i deritanishëm i zyrës për kthim të UNMIK-ut, në një konferencë me gazetarë tha se të zhvendosurit nga Kosova do të mund të kthehen në të ardhmen në vendet ku ata dëshirojnë. 6.500 familje parashihet që të kthehen në mënyrë të organizuar si dhe 2.000 familje të tjera në mënyrë individuale. Gjithsej bëhet fjalë për rreth 35.000 banorë të cilët Serbia planifikon t'i sjellë në vendet ku serbët tashmë janë shumicë, atje ku ata me këtë kthim do të bëheshin shumicë, ose atje ku nëpërmjet kthimit do të sigurohej

vazhdimësia territoriale e enklavave. Kurse, më 6 qershor 2006, u nënshkrua 'Protokoli për Kthimin Vullnetar dhe të Qëndrueshëm' ('Protocol on Voluntary and Sustainable Return') ndërmjet IPVQ-ve të përfaqësuar nga Dardan Gashi, Delegacionit të Grupit Punues për Dialog të Drejtpërdrejtë të udhëhequr prej Milorad Todoroviqit dhe UNMIK-ut të përfaqësuar prej PSSP-së së atëhershëm, Soren Jessen-Petersen. Në nenin II, pika 5, thuhet që serbët kanë të drejtë të kthehen edhe aty ku ata zgjedhin, e jo vetëm në vendet ku ata kanë jetuar më parë. Përveç kësaj është e rëndësishme të thuhet që në krejt dokumentin, ashtu siç edhe në të gjitha dokumentet tjera që kanë të bëjnë me kthimin e serbëve që kanë ikur nga Kosova, përdoret shprehja 'persona të zhvendosur së brendshmi' (IDP - Internally Displaced Persons). Sipas fjalorit standard të Komisionerit të Lartë për Refugjatë në Kombet e Bashkuara (UNHCR), kjo shprehje përdoret ekskluzivisht për ata persona, të cilët, për shkak të konflikteve të armatosura apo katastrofave natyrore detyrohen ta ndërrojnë vendbanimin, por pa e ndërruar shtetin. Pra, ata janë të zhvendosur, përkundër refugjatit, i cili është person, i cili, për shkak të arsyeve të lartpërmendura vendqëndrimin e ndërron prej shtetit të tij, në një shtet tjetër. Serbët e ikur në Serbi, pra trajtohen vetëm si persona të zhvendosur së brendshmi, ngaqë, Rezoluta 1244 ruan sovranitetin e Serbisë mbi Kosovën.

Më 21 shkurt 2006, Qendra Koordinuese e Serbisë për Kosovën (QKSK), publikoi lajmin se udhëheqësja e kësaj Qendre, Sanda Rashkoviç-Iviq dhe Ministri për Investime Kapitale, Velimir Iliq, kanë nënshkruar protokolin e vlefshëm 115 milionë dinarë për ndihmë personave të zhvendosur nga Kosova. 95 milionë dinarë janë ndarë për ndërtimin e 70 shtëpive ndërmjet Badocit të Ri dhe Graçanicës për serbët e ikur më 17 mars të vitit 2004. Tashmë dy shtëpi veç janë ndërtuar në fshatin Badoc i Ri. Ndërkaq, 20 milionë dinarë do të përdoren për infrastrukturën e nevojshme për furnizimin me ujë të Badocit të Ri. Të gjitha shtëpitë e djegura gjatë 17 e 18 marsit të vitit 2004, i ka rindërtuar Qeveria e Kosovës me paratë e buxhetit të Kosovës. Nuk ka arsye që të ndërtohen shtëpi atje. Beogradi po ndërton shtëpi shtesë, sepse do që ta krijojë një zinxhir të fshatrave serbe ndërmjet Artanës dhe Graçanicës, dhe kësajsoj të lidhen fuqishëm territoret në Anamoravë me fshatrat e banuara me serbë në pjesën qendrore të Kosovës. Nga Artana përmes fshatrave Izvor e Dragoc krijohet lidhja me fshatrat Hanroc, Shishare, Shashkoc, Okosnicë, Badoc e Graçanicë. Me krijimin e

VETËVENDOSJE !

komunës së Graçanicës, krijohet lidhja me fshatrat e banuara me serbë në komunën e Fushë Kosovës, Lypjanit dhe Kastriotit. Graçanica lidhet me Uglarin dhe fshatrat tjera të banuara me serbë në Fushë Kosovë përmes fshatrave Llaplasellë, Preoc e Çagllavicë si dhe me fshatrat Livaxhë, Skullan, Lepi e Radevë në komunën e Lypjanit nëpërmjet fshatit Sushicë. Nga fshati Uglar i cili gjendet në komunën e Fushë Kosovës, përmes fshatit Nakaradë depërtohet në fshatrat e Kastriotit: Krushec, Caravadicë e Leshkoshiq.

Në hartën 21, të publikuar kah fundi i vitit të kaluar, me rrathë të zinj që kanë nga një X në mes janë paraqitur zonat e banimit kolektiv në kuadër të kthimit të organizuar masiv të serbëve sipas planit të Qendrës Koordinuese të Serbisë për Kosovën (QKSK). Me ngjyrë të verdhë janë shenjuar vendbanimet ku përkrahet kthimi individual ndërsa me ngjyrë të kuqe ato për kthim të organizuar e masiv të serbëve në Kosovë. Vërehet se një zonë e banimit kolektiv është paraparë në afërsi të Graçanicës. Dihet që serbët nuk e kanë lëshuar Graçanicën as pas mbarimit të luftimeve. Atëherë, kush po kthehet aty?! Në emër të 'kthimit të qëndrueshëm' po bëhet rikolonizimi i Kosovës meqë serbëve po u pranohet e drejta që të kthehen ku të duan, pra jo vetëm te prona e tyre. Në rastin e ndërtimit të banesave kolektive për kolonët e rinj serbë në Graçanicë, qëllimin e Serbisë po e realizon Kuvendi Komunal i Prishtinës me në krye Ismet Beqirin. Kuvendi Komunal i Prishtinës, me datën 21 shkurt të vitit 2006, ka përcaktuar lokacionin prej përafërsisht 54 ari, për ndërtimin e 'katër objekteve të tërësisë së përbashkët në fshatin Graçanicë'. Kjo është bërë duke u thirrur në nenin 3.1b) të Rregullores 2000/45, që ka të bëjë me planifikimin urban dhe të fshatit dhe shfrytëzimin e tokës. Pra, rregullorja për vetëqeverisjen e komunave përveç për decentralizim, është treguar e përdorshme edhe për rikolonizimin e Kosovës. Në faksimilin 22 është paraqitur vendimi kolaboracionist i Kuvendit Komunal të Prishtinës lidhur me këtë.

Në anën tjetër, CIMIC raportin javor nr. 1148 të KFOR-it, të datës 8 shkurt 2006, thuhet se numri i shtëpive dhe banesave të blera në veri të Mitrovicës brenda një viti nga QKSK, e tejkalon numrin 150. Muaj më parë dy transaksione kanë ndodhur në Kodrën e Minatorëve - njëra e blerë nga QKSK dhe tjetra nga Kisha Ortodokse. Pesë banesa të njërit nga tre soliterat i janë shitur QKSK-së që nga tetori i vitit 2005, ndërsa, para disa muajve, një ndërtesë pesëkatëshe ndërmjet soliterëve i është shitur po

ashtu QKSK-së për 300.000 euro. Blerjen po e bën Serbia, jo serbët. Andaj bëhet fjalë vetëm edhe për një aspekt tjetër të rikolonizimit.

Asnjë zyrtar dhe asnjë kryeadministrator i UNMIK-ut asnjëherë në asnjë mënyrë nuk e kundërshtuan politikën e Beogradit që blen prona të shqiptarëve për t'i pastruar etnikisht ata prej aty. Madje, kjo është në kundërshtim edhe me vetë rregulloren e UNMIK-ut 2001/17 e nënshkruar nga Hans Hakkerup më 22 gusht 2001. Kjo rregullore, në seksionin e tretë të saj në pikën 3.1 a) thotë që administratori komunal i UNMIK-ut mund të refuzojë të regjistrojë kontratën për shitjen e pronës së banimit nëse ka bazë të mjaftueshme për të besuar se transaksioni është bërë ose përkrahur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga ndonjë organizatë ose strukturë me qëllim që sistematikisht të blejë pronësi të minoritarëve, në mënyrë që ta ndryshojë përbërjen etnike përbrenda një treve të caktuar. Serbia, nëpërmjet QKSK-së po blen prona të shqiptarëve në veri të Kosovës të cilët kanë mbetur pakicë atje. UNMIK-u e di shumë mirë dhe e lejon këtë, duke bërë edhe shkelje të rregulloreve të veta.

Gazeta ditore e Beogradit 'Politika', më 1 shkurt 2006, paralajmëroi se si komunat nga Serbia dhe Vojvodina, e madje edhe Republika Serbe në Bosnjë, do të ndihmojnë kthimin e serbëve si dhe komunat e reja serbe në Kosovë që do të krijohen së shpejti, duke bërë ndërtimin e 1.200 shtëpive, secila për dy familje serbe. Nëse supozojmë që një familje ka mesatarisht 4 anëtarë, kjo do të thotë se sipas këtij plani, parashihet që 9.600 persona do të vendosen nëpër vendbanime kolektive gjatë këtij viti. Në bazë të planit të QKSK-së të bërë publik tash së voni, kthimi nënkupton kthimin e organizuar të 6.500 familjeve dhe përkrahjen për kthimin individual të 2.000 familjeve tjera.

Nëpërmjet decentralizimit dhe krijimit të zonave të veçanta mbrojtëse përreth kishave dhe manastireve ortodokse po synohet përcaktimi i kufijve të brendshëm në Kosovë të cilët përkufizojnë entitetin serb brenda Kosovës. Planit serb parasheh bashkimin e enklavave serbe, duke krijuar enklava tjera të reja përbrenda, por që kësaj radhe janë shqiptare. 'Kthimi i qëndrueshëm' në Kosovë lidhet me trashëgiminë kulturore, sepse kthimi mendohet që të ngajë te trashëgimia kulturore pasi që kjo ta ketë fituar statusin e Zonës së Veçantë. 'Kthimi i qëndrueshëm' lidhet edhe me

VETËVENDOSJE !

decentralizimin sepse Serbia do që t'i kthejë serbët atje ku mendon të krijojë entitetin e veçantë të tyre.

Për realizimin e të gjitha këtyre janë ndërmarrur edhe masa të tjera konkrete. Para se kryeadministratori Petersen të jep lejen për dy ministritë e reja për Kosovën (Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe atë të Drejtësisë), udhëheqësja e QKSK-së, Sanda Rashkoviç-Iviq, me 6 dhjetor 2005, u mor vesh në Beograd me zëvendëskryeadministratorin dhe Shefin e Shtyllës së Parë të UNMIK-ut, Jean Dussourd, që në Kosovë të krijohen 14 nënstacione të reja policore, prej të cilave 12 në vendet ku shumicë janë serbët. Zëdhënësi i UNMIK-ut, Neeraj Singh, në konferencën për shtyp të mbajtur më 12 prill 2006, ka deklaruar se "...gjatë këtij muaji, 13 nënstacione policore do të vendosen në nivele të fshatrave, 11 prej të cilave në hapsirat e serbëve të Kosovës." Pra, në muajin prill u materializua marrëveshja sekrete të cilën Sanda Rashkoviç-Iviq e bëri me zëvendëskryeadministratorin dhe shefin e shtyllës së parë të UNMIK-ut, Jean Dussourd, më 6 dhjetor 2005 në Beograd. Pra, Serbia po fiton substancë solide në Kosovë, ndërkaq Kosova - edhe më shumë administratë formale dhe ministri simbolike. Me këto nënstacione policore, Serbia mëton që të krijojë mbrojtje paraprake për rikolonizimin por edhe të etablojë kufijtë e ri të brendshëm, së pari si kufij të zonave të operimit të këtyre nënstacioneve. Në Kosovë tashmë janë 33 stacione policore prej të cilave 5 sosh e kanë shumicën e stafit serbë. Edhe 12 nënstacione të reja për serbët që janë vetëm 6% të popullatës së Kosovës nuk bëhen për sigurinë e serbëve por për sigurimin e Serbisë brenda Kosovës, entitetit të kontrolluar nga ajo që do të legalizohet e zyrtarizohet. Serbia s'çan kokën për njerëzit dhe gjendjen e tyre, kushdo qofshin ata. Ajo brengoset vetëm për strukturat e saj, jo për njerëzit. Ajo i inkurajon serbët e Kosovës që të qarkullojnë me vetura që mbajnë targa të Serbisë, jo vetëm për ta dëshmuar veten e saj si shtet në Kosovë, por duke presupozuar që ata serbë të gjerë asisoj do t'i bëjë shënjestër të shqiptarëve. Serbia do që t'i rrezikojë serbët e zakonshëm. Ajo do që ata të vriten e lëndohen. E çfarë ruan Serbia në Kosovë? Ajo i ruan 'rojet e urës', sikurse edhe forcat e tjera të 'sigurisë' që i ka në Kosovë. Të gjithë ata po i inkuadron si pjesëtarë të SHPK-së, të gjithë ata praktikisht po i maskon. Serbia kujdeset për sigurinë e forcave të saj të 'sigurisë', jo për sigurinë e serbëve civil. Ata mendon t'i kthejë në Kosovë për t'i përdorur e assesi për t'ua përmirësuar jetesën. Dihet se Serbia financon

strukturat e saj në Kosovë. Përkundër kësaj ka shumë serbë të varfër dhe madje në varfëri të thellë në Kosovë, ngase nga Serbia përfitojnë pikërisht vetëm strukturat e saj, jo edhe njerëzit e zakonshëm.

Të gjitha këto plane të Serbisë për rikolonizimin e Kosovës i kanë përjetuar edhe të parët tanë. Ato duhet të kundërshtohen me të gjitha mënyrat. Sa më shpejt, aq më mirë dhe më lehtë do të jetë. Jo vetëm për neve, por edhe për brezat që vijnë.

Në vijim janë dhënë fshatrat dhe qytetet nëpër regjionet përkatëse në Kosovë ku Serbia po i kthen apo planifikon t'i kthejë serbët.

Regjioni i Mitrovicës

LEPOSAVIQ

Kthimi individual: Belloberdë, Bistricë, Borçan, Vraçevë, Vuçë, Krnin i Epërm, Graniçan, Gumnishtë, Krnin i Poshtëm, Dren, Kamenicë, Kijevçiq, Leposaviq, Leshak, Sllatinë, Soçanicë, Trebiq, Cerajë, Bistrica e Shalës, Majdevë, Ostraq, Popoc, Potkonjë, Pridvoricë.

ZUBIN POTOK

Kthimi individual: Banjë, Bërnjak, Bube, Kalludër e Madhe, Vele Brijeg, Varagë, Dren, Zubin Potok, Zupç, Jagnjenicë, Lluçkarekë, Megjipotok, Oklac, Tushiqë, Crepulë, Çeçevë.

ZVEÇAN

Kthimi individual: Banovdoll, Banjskë, Vallaq, Rudar i Vogël, Graboc, Dolanë, Zherovnicë, Zhitkoc, Zveçan, Izvor, Jankov Potok, Korillë, Llovac, Maticë, Rudinë, Sendojë, Serbovec.

MITROVICA

Kthimi individual: Mitrovicë, Suhodoll, Frashër.

SKËNDERAJ

Kthimi individual: Bajë.

VUSHTRRI

Kthimi individual: Gojbujë, Gracë, Prelluzhë.

Kthimi i organizuar që tashmë ka filluar: Magjunaj

Kthimi i planifikuar: Miroçë, Nedakoc, Vrnice.

Regjioni i Pejës

BURIM

Kthimi individual: Cërkolez, Suriganë.

Kthimi i organizuar që tashmë ka filluar: Tuçep, Shalinoc, Osojan, Llukafc i Thatë.

Kthimi i planifikuar: Kërrninë, Belicë, Bellopojë, Gjurakoc, Dragollec, Zallq, Zhakovë, Burim, Kosh, Osojan, Polanë, Sinajë, Veriq, Prekallë, Lubozhdë, Kovragë, Dubravë, Serbobran.

PEJË

Kthimi individual: Brestovik, Gorazhdec.

Kthimi i organizuar që tashmë ka filluar: Bellopojë, Lëvoshë.

Kthimi i planifikuar: Cerovërhë, Pejë, Sigë, Vitomiricë, Zagërmë.

KLINA

Kthimi i organizuar që tashmë ka filluar: Bixhë, Grabc.

Kthimi i planifikuar: Bërkovë, Budisalc, Dollc, Drenik, Drenoc, Drenovçiq, Klinë, Vide, Shtupel.

Regjioni i Prishtinës

PRISHTINA

Kthimi individual: Çaglavicë, Badofc, Graçanicë, Lapllasellë, Preoc, Slivovë, Shushicë, Bërnice e Epërme, Nëntë Jugoviqët, Bërnice, Lebane.

Kthimi i planifikuar: Dragoc, Prishtinë.

FUSHË KOSOVË

Kthimi individual: Batushë, Fushë Kosovë, Kuzmin, Uglar.

Kthimi i planifikuar: Miradi e Epërme.

KASTRIOT

Kthimi individual: Babimoc, Caravodicë, Milloshevë, Kastriot, Plemetin.

Kthimi i planifikuar: Krushec.

LIPJAN

Kthimi individual: Dobratin, Gushtericë e Ulët, Goleshko Vrello, Gushtericë e Epërme, Janjevë, Lepi, Livaxhë, Dobrajë e Vogël, Radevë, Skullan, Grackë e Vjetër, Suhodoll.

Kthimi i planifikuar: **Silovi, Magurë.**

Regjioni i Anamoravës

DARDANË

Kthimi individual: Qarakofc, Hajnoc, Bozhofc, Bollefc, Bratillofc, Bushincë, Carefc, Domoroc, Kormnjan i Poshtëm, Drenoc, Gogollofc, Kormnjan i Epërm, Kolloleç, Dardanë, Kostadincë, Leshtar, Ropotovë e Vogël, Moçarë, Odevcë, Panqelë, Rajnovc, Strelicë, Strezofc, Romancë, Vaganesh, Ropotovë e Madhe.

Kthimi i planifikuar: Firiqejë, Tirincë, Koretin, Leshtar, Rahovicë.

GJILAN

Kthimi individual: Cernicë, Budriga e Ulët, Livoç i Poshtëm, Dragancë, Kufcë e Epërme, Livoç i Epërm, Makresh i Epërm, Kmetofc, Parallovë, Partesh, Pasjan, Ponesh, Stanishor, Strazhë, Shillovë, Koretishtë.

Kthimi i organizuar që tashmë ka filluar: Muzgovë.

Kthimi i planifikuar: **Gjilan, Zhegër, Përlepnice.**

SHTËRPECË

Kthimi individual: Berovc 1, Berovc 2, Bitijë e Poshtme, Drajkofc, Bitijë e Epërme, Gotovushë, Jazhincë, Sevc, Sushicë, Viçë, Vërbeshticë, Shtërpçë.

FERIZAJ

Kthimi i organizuar që tashmë ka filluar: Bablak.

Kthimi i planifikuar: Nerodime e Epërme, Babush.

ARTANË

Kthimi individual: Bostane, Izvor, Jasenovik, Llabjan, Manushinc, Prekoc, Tërniqefc, Zebnicë.

Kthimi i organizuar që tashmë ka filluar: Kllobukar.

Kthimi i planifikuar: Artanë.

VITI

Kthimi individual: Binçë, Gërnqar, Kllokot, Letnicë, Mogillë, Viti, Vërboc, Vërnavokollë, Vërnez, Shashare.

Kthimi i organizuar që tashmë ka filluar: Podgorc.

Kthimi i planifikuar: Zhiti, Tërpezë, Gërmovë, Gushicë, Kabash, Novosellë.

Regjioni i Prizrenit

SHARR

Kthimi individual: Baçkë, Brod, Dikancë, Sharr, Gllloboçicë I, Kërsteç, Krushevë, Kukujan, Leshtan, Lubivshhtë, Mlikë, Oruçashë, Radeshë, Rapçë, Restelicë, Vranishtë, Zlipotok.

RAHOVEC

Kthimi individual: Hoçë e madhe, Rahovec.

Kthimi i planifikuar: Zaçishtë, Opterushë.

PRIZREN

Kthimi individual: Drajçiq, Urbiçan.

Kthimi i organizuar që tashmë ka filluar: Llokvicë, Mushnikovë, Novak, Pllanjan, Sreckë.


Kthimi i planifikuar: Dojnicë, Gornjasellë, Zhivinjan, Lubizhdë, Smaq, Prizren.



Координациони центар Србије и Црне Горе
и Републике Србије за Косово и Метохију



МАСОВНИ ОРГАНИЗОВАНИ ПОВРАТАК



Harta 21



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINË / MUNICIPALITY ASSEMBLY PRISHTINA / SKUPŠTINA OPŠTINA PRISHTINA

Në bazë të nenit 3, par.1, pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, nenit 19, par.1, pika b, dhe nenit 40 të Statutit dhe Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.02.2006 merr

V E N D I M

MBI ÇAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E KATËR OBJEKTEVE TË TËRËSISË SË PËRBASHKËT (KOLEKTIVE) NË FSHATIN GRAÇANICË

Neni 1

Miratohet Vendimi për çaktimin e lokacionit për ndërtimin e katër objekteve të tërësisë së përbashkët (kolektive) në fshatin Graçanicë .

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit, sipas këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr. 597/1, Zona kadastrale-Graçanicë, fleta poseduese nr. 499, në sipërfaqe përafërsisht prej 54,0 arë, e evidencuar si pronë shoqërore-pasuri e fshatit.

Neni 3

Destinimi i caktuar i lokacionit, sipas këtij Vendimi, do të inkorporohet në planin e ardhshëm zhvillimor të komunës së Prishtinës dhe në Planin rregullativ për këtë zonë.

Neni 4

Ky Vendim paraqet bazë për dhënien e pëlqimit në lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejinën e ndërtimit të objekteve investive për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Kushtet dhe kriteret për ndarjen e banesave bëhen nga komisioni përkatës i formuar nga ana e Bordit të drejtorëve dhe Zyrës së komiteteve në Graçanicë

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimitarisë dhe Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë të Komunës së Prishtinës të cilët do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre të caktruara për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

DI. Nr. 353 - K7, më 21.02.2006



KRYETARI I KUVENDIT

Ismet Beqiri

Faksimili 22